

БИБЛИОТЕКА АРХИВА
ЗА АРБАНАСКУ СТАРИНУ, ЈЕЗИК И ЕТНОЛОГИЈУ
УРЕДНИК УНИВ. ПРОФ. ДР. Х. БАРИЋ

Историјска серија.

Књ. II., Св. 1.

**STATUTA ET ORDINATIONES
CAPITULI ECCLESIAE CATHEDRALIS
DRIVASTENSIS**

EDIDERUNT ET CURAVERUNT CUM PRAEFATIONE ET NOTIS
PALAEOGRAPHICIS

DR. VICTOR NOVAK et DR. AEMILIANUS ŠUFFLAY



MILAN ŠUFFLAY - FAXIMIL 1
ŠHTETIA E LIBRIT OMBRA GVG

ИЗДАЊЕ СЕМИНАРА ЗА АРБАНАСКУ ФИЛОЛОГИЈА
УНИВЕРСИТЕТА У БЕОГРАДУ

БЕОГРАД 1927

~ I ~

KARAKTERISTIKA TË QYTETIT TË DRISHTIT



Pozita dhe themelimi i qytetit dhe varoshit - Qytetet binjake Shkodër e Drisht në varoshet e rrethit të Dioklesë - Vdekja natyrore e romanëve (1478) - Veçoritë e qytetit bregdetar të bartura në hinterlandin ballkanik - Fole mesjetare romano-franceze në vrullin e zhvillimeve të Perandorisë së Lindjes - Familjet fisnike Bello, Colomba, Lepore, Schipudar, Summa - Famija e Spanëve - Ndikimi serb: dukët dhe kontët e Drishtit - Qyteti latin mesjetar në trekëndëshin kufitar të popujve, pushtetit dhe fesë - Vendbanimi i hershëm turk rreth Shkodrës e Danjës - Simpatitë e qytetarëve për Venedikun.



Në hyrjen romantike të viseve malore shqiptare, 10 kilometra në verilindje të Shkodrës, në breg të lumit Kir në një kodër 150 m të lartë, gjenden rrënojat e varoshit të qytetit të Drishtit. Nga kodra hapet një horizont i mrekullueshëm i luginës së Kirit, Shkodrës dhe liqenit moçalor deri në kufijtë e malit Maranaj. Brigjet e lumit Kir dhe hurdat e përroit të Drishtit (*Proni i Drishtit*)¹ e bëjnë të pakalueshme anën jugore, perëndimore dhe veriore të kalasë së Drishtit. Vetëm përmes anës lindore mund të kalohet sipër rrafshnaltës së Cukalit.²

Në majën e asaj kodre, ka qenë qyteti që bizantinët e thërrisnin *Δριβαστον*, latinët *Drivastum*, serbët *Drivost* dhe *Drevos*, romanët dhe italianët *Drivasto*, *Drievasto*, *Drivest*. Fshati i sotëm afër rrënojave mban emrin *Drisht*, saktësisht *Drishti*, sipas rregullave të drejtshkrimit të alfabetit të gjuhës shqipe, nga toponimi i hershëm *Drivastum*.³ Qyteti (*citadela*) kishte formë shumëkëndëshi jo të rregullt me kulla të nxjerra jashtë. Në qytet nuk kishte burime uji. Kjo gjë vërehet nga fakti se venedikasit (1397-1404) rindërtojnë një depozitë uji (sternë). Uji i pijshëm të cilin e lavdëron

¹ *Toponim i M. Šufflay-t. (M. A.)*

² Rrënojat i kanë përshkuar: Gopčević, *Oberalbanien und seine Liga*. Leipzig 1881, 152; po ai, *Fürstentum Albanien*. Berlin, 1881, 307; Ippen, *Glasnik bosanskog mezeja*. 12, 1900, 520; po ai, *Wissenschaftliche Mitteilungen*. 10, 9 (me fotografi dhe skica planimetricke); Degrand, *Souvenirs de la Haute Albanie*. Paris, 1901, 88; Baldacci, *Nell'Albania settentrionale*, 1897, në: *Bulletin della società geografica*. Separat i veçantë. Roma, 25, 1915, 30.

³ Skok, *Arbiv za arb. starinu*. 1, 1923, 10.

canonicus Drivastensis, idemque parochus S. Mariae de Civitate Veteri diocesis Drivastensis), ipeshkv i Drishtit.¹¹

Pra, në atë kohë, Varoshi i vjetër ishte famullia e kishës së Shën Mërisë (1403, S. Maria Vetus) i kishës së Shën Nikollës në rrafshnaltë. Kisha ishte boshatisur dhe kishte kaluar si mëlçi e varur e varoshit nën *citadelën* e qytetit, sipas të gjitha gjasave, gjatë kohës së sulmit të mongolëve (1241).

Sipas pozitës së tij gjeografike, origjinës dhe sipas strukturës etnike dhe sociale, Drishti është i njëjtë me Tivarin, Ulqinin, Shkodrën, Shasin, Danjën e Balecin, në vargun e përbashkët të qyteteve të Dioklesë, që shtriheshin nga veriu i Lezhës, nën sundimin bizantin, deri afër Dubrovnikut të zgjeruar, duke zënë një vend shumë të veçantë në rrethin kulturor të Adriatikut të lashtë. Ky cikël vazhdueshmërie vazhdon nga Trani¹² deri në Lezhë, që formon dy polet e saj. Vazhdueshmëria diokleaze që përbënte polin verior, përcaktoi në Adriatikon lindor një kalueshmëri nga jugu apulo-arbëror në veriun dalmatino-italian.¹³ Në aspektin politik dhe kishtar, Drishti ka pasur fatin e qyteteve diokleaze. Fillimisht bënte pjesë në themën e mitropolisë së Durrësit. Pas kalimit të Tivarit (1022) nën pushtetin kryepeshkvnor të Dubrovnikut, Drishti luhetet mes Dubrovnikut dhe Tivarit, i cili për tre shekuj (1089-1255) zhvilloi një luftë të pakompromisë për të drejta metropolitane për qytetet e Dioklesë.¹⁴ Nga këndvështrimi politik, binjak i Drishtit është Shkodra. Bashkë me këtë të fundit, edhe Drishti u vu nën pushtetin e princit Bodin të Dioklesë në fund të shekullit të njëmbëdhjetë. Pas vdekjes së perandorit të Bizantit Emanuel Komnenit në vitin 1185, pushtetin e Bodinit e mori Stefan Nemanja. Pas shkatërrimit të perandorisë së Dushanit, Drishtin e morën në sundim Balshajt, dhe në vitin 1396, Drishti u dorëzohet venedikasve bashkë me Shkodrën. Distrikti i këtyre dy qyteteve kufizohet me njeri-tjetrin. Në sundimin venedikas (1397-1399 dhe 1450-1452) ka edhe konflikte të rënda midis Shkodrës dhe Drishtit për shkak të kufijve të tyre.¹⁵ Megjithatë, marrëdhëniet intime vërehen kryesisht nga fakti se në vitin 1442 në Drisht janë të vlefshme aktet noteriale që qytetarët i japin të shkruhen te noterët shkodranë (*omnis Drivastinus habens terram vel possessionem cum cartis vel instrumentis factis per notarios Scutarinos debeat eas habere*).¹⁶ Nga kjo vërehet që familja Spani ka shtëpitë e saj në Drisht dhe në Shkodër, që Jonimët shkodranë kanë fisin e tyre edhe në Drisht (në statut përmendet si kanonik Gjergj Jonima), ashtu sikurse familja Prekali ishin pronarë tokash në Shkodrën dhe mbiemri i tyre ndeshet si mbiemër fisnikësh edhe në Drisht “Pisciragus” (në statut: kanonik Nikolla) me siguri identik me atë të Shkodrës, ndoshta në formë pak më të shtrembëruar të mbiemrit “Pintzenago”.¹⁷

A

¹¹ Ljubić, Listine, 9, 158 (1442); Farlatus, *Illyricum Sacrum* 7, 242, (1457); Šufflay, *Städte*. 26; Shih: Šišić, *Povijest Hrvata*. Zabreb, 1925, 1, 441, ref. 26.

¹² *Trogiri. Qytet në Kroaci. (M.A.)*.

¹³ Šufflay, *Städte*, 4; po ai: *Srbi e Arbanasi*, 12.

¹⁴ Šufflay, *Kirchenzustände im mittelalterlichen Albanien*. Në: *Vjenski hrvačkoga arhiva*. 17, (1915), 9-15; po ai: po ai: *Srbi e Arbanasi*, 86-90; Thallóczy, *Illyrisch-Albanische Forschungen*. München-Leipzig, 1, 199-208.

¹⁵ Šufflay, *Städte*, 41. Për konfliktin nga viti 1399, shiko: Scapolo, *Venezija e Albania*. Në: *L'Ateneo Veneto*. 31, 1918, korrik-gusht, 247-249; për distriktin e Shkodrës shih Kadastrin nga viti 1416 (Ljubić, *Starine*, 14. Për kufijtë e distriktit të Drishtit, të dhëna të shumta përmban marrëveshja mes despotit Gjergj (Balsha, *M. A.*) dhe Venedikut nga viti 1426. Ljubić, Listine, 9, 15.



II

STATUTI I KAPITULLIT TË DRISHTIT - 1456 -



Si ka ardhur deri te editimi i këtyre Statuteve dhe si deri te përbërja (1456 dhe konfirmi i tyre (1464) - Neni I, “për respektimin e pleqve” - Shkatërrimi i menzave të ipeshkvijve në Diokle - Kanonikët e shquar të qyteteve diokleane - Kanonik në Drisht mund të ishte vetëm fisniku vendas (neni 46) - Anarkia kishtarë në Tivar: “kapitulli i parë i katedrales dhe kapitujt e tjerë të kishave kolegiatë” - Një paralele në mes të Ullqinit dhe Splitit - Kishat kolegiatë në territoret e hapura - Kanonikët e Shën Mërisë dhe kanonikët e Shën Gjergjit në Drisht (1400) - Një e dhënë interesante e trashëguar nga përbërja e kapitullit: Shtëpia e kanonikëve dhe jeta tërësisht e përbashkët e kanonikëve të Drishtit deri në vitin 1478.



Si qytet i vërtetë bregdetar, edhe Drishti kishte statutet e qytetit. Këto, sikurse edhe ato të qytetit të Durrësit (1392) dhe të Shkodrës (1396), përmenden¹⁵² me rastin e ardhjes së pushtetit të Venedikut (1397, *antiqua statuta*). Edhe më parë, në disa formulime të dokumenteve noteriale, aludohet në statute të qytetit të Tivarit (1368) dhe Ullqinit (1376). Me rastin e dërgimit të qeveritarit të tij, në qytetin e Danjës, Venediku e këshillon atë “që të ushtrojë të drejtën civile sipas statuteve vendase.”¹⁵³ Nga të gjithë këto Statute të përmendura nuk janë gjetur më shumë se disa fragmente të shkëputura. Në jug të qyteteve bregdetare të Adriatikut lindor na janë të njohura vetëm statutet e qytetit të Budvës, të kodifikuara gjatë kohës së perandorit Dushan (1348-1351).

Kur në katalogun e antikuarit të Lajpicigut, Hiersemann 438, (qershor 1915), 43, n° 250, gjeta shënimin krejt të thjeshtë dhe sipërfaqësor për dorëshkrimin e “*Statuta et ordinationes ecclesiae cathedralis Drivastensis*,” isha i bindur se këto janë statute të qytetit, me rëndësi të jashtëza-

¹⁵² Për statutet e qyteteve të Adriatikut Lindor shih: Šufflay, *Städte*, 68-71.

¹⁵³ Senato Mar, 2, f. 108.